

**SHEZAI RROKAJ****TOSKËRISHTJA VERIORE DHE GEGNISHTJA JUGORE NË  
KËNDVËSHTRIMIN E JORGJI GJINARIT**

Më jepet rasti, me këtë punim, të shpreh disa mendime dhe vlerësime për njërin prej figurave të shquara të gjuhësisë shqiptare, siç është kjo e profesor Jorgji Gjinarit, në një datë të veçantë për të e për ne, në 85-vjetorin e lindjes së tij. Ndaj edhe dua të falënderoj organizatorët e konferencës “Kontributi i prof. Jorgji Gjinarit në studimet dialektologjike të shqipes”, të cilët menduan të realizojnë këtë tubim shkencor në përvjetorin e tij të lindjes.

Profesor Jorgji Gjinari është pa dyshim një nga dialektologët më të spikatur shqiptarë, autor i disa monografive e teksteve universitare mbi dialektologjinë. Ai është studiuesi që ka shkelur çdo pëllëmbë të trevës shqiptare, aty ku fjala gjëllin bukur në shtratin e vet. Së bashku edhe me dialektologë të tjerë të shquar, ai dha modelin e studimit për shumë breza se faktet e shqipes studiohen më mirë sinkronikisht kur ato preken *ex cathedra*, më aty ku shfaqen. Kjo është edhe arsyeja përse studimet e tij mbeten sot e gjithë ditën koherente dhe me vlerë. Nga ana tjetër, profesor Jorgji Gjinari ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme edhe në fusha të tjera të gjuhësisë diakronike si: dialektologjia historike, çështje që lidhen me prejardhjen e gjuhës shqipe e, në mënyrë të veçantë, shumë trajtime për marrëdhëniet e dialekteve me gjuhën shqipe standarde.

Në këtë shumësi prurjesh shkencore, studiuesi Gjinari i kushtoi një vend të posaçëm toskërishtes veriore, duke e përqsaur atë edhe me gegërishten jugore, të cilat prekin arealin gjeografik nga mbi Vjosa deri në Mat<sup>1</sup>. Në fakt, studime kaq komplekse, që rrokjin një areal kaq të gjerë dialektologjik mbështeteshin në një varg studimesh e anketash dialektologjike, të kryera nga studiues albanologë e shqiptarë, ku mjaft syresh janë realizuar nga vetë Jorgji Gjinari<sup>2</sup>. Studimet në terren sollën të dhëna

---

<sup>1</sup> J. Gjinari, *Tipare të të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me atë të gegërishtes jugore*, SF, nr. 2, 1965, f. 129-137.

<sup>2</sup> A. Dozon, *Manuel de la langue la langue chkip ou albanaise*, Paris, 1879; G. Weigand, *Albaninesischen Grammatik*, Leipsig, 1913; G. Hahn, *Albaninesischen studien* (përkth.); Q. Haxhihasani, *Nji vështrim mbi të folmen e krahinës së Sulovës*, Bulet. Shk. Shoq. nr. 3, 1955; Disa anketa dialektologjike të bëra prej Q. Haxhihasanit në Vërçë, Shpat, Polis, Domosdovë, Nahije e Beratit dhe Kolonjë, M. Totoni për krahinën e Dëshnicës, vetë Gjinari për zonën e Tepelenës toske, Fushën e Korçës, Pogradecin dhe Gorën, Nahijen e Beratit etj, M. Çeliku për Krrabën, Peqinin, Darsin, Shpatin, Çermenikën, Durrësin, Shijakun, etj.; S. Floqi, *Skicë e së folmes së*

mjaft interesante në fushën fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore. Siç do ta shohim më tej, këto të dhëna sqaronin gjendjen e gjuhës në këto të folme, duke krijuar një shtrat të qëndrueshëm për të ndërmarrë në vijim studime krahasuese midis të folmeve, ku dilnin në pah tiparet e përbashkëta dhe dallimet.

Përveç kësaj, studimet sillnin të dhëna me vlerë përsa i përket fjalorthit të zonës, sikundër edhe tekste origjinale bisedash, dromca xhevairesh kulturore, që shpërfaqnin gjithë mozaikun e gjallesës në këto troje. Nga ky këndvështrim mund të pohojmë pa mëdyshje se gjithë kjo pasuri dialektologjike e kësaj treve dhe e trevave të tjera, e cila është tashmë e arkivuar, ka shërbyer dhe do të shërbejë jo vetëm si dëshmi e një “fotografimi” gjuhësor në një prerje sinkronike të caktuar, por prej bazës së saj janë ndërmarrë dhe do të ndërmerren studime frytdhënëse në fushë të historisë së gjuhës dhe sidomos për krijimin e gjuhës standarde shqipe, së cilës profesor Jorgji i kushtoi një vëmendje të veçantë<sup>3</sup>.

Toskërishtja përfshin gjithë dialektin e pjesës jugore të Shqipërisë, afërsisht deri në Shkumbin, duke lënë mënjanë disa të folme tranzitore<sup>4</sup>. Ky emër ka ardhur e është shtrirë për gjithë këtë trevë, kurse më parë ai kuptonte vetëm territorin mbi Vjosë. Në toskërishten veriore përfshihen zona e Myzeqesë, Berati me Nahijen e tij, Mallakastra dhe Skrapari, qarku i Korçës, zona e Dangllisë dhe Sherisë, Dëshnica dhe Tepelena toske në të djathtë të Vjosës<sup>5</sup>. Sipas autorit, këto të folme paraqesin “një njësi unike dialektore brënda dialektit jugor” toskë, krahas labërishtes dhe çamërishtes.

Si tipare të përgjithshme përbashkuese të të folmeve të kësaj treve ai dallon:

*Dangllisë*, Bulet. U.Sh.T. nr. 3, 1958; V. Xhaçka, *Një vështrim mbi të folmen e Devollit*, Bulet. U.Sh.T. nr. 3, 1958; J. Thomaj, *E folmja e katundit Seman*, Bulet. U.Sh.T., nr.3, 1961; M. Çeliku, *Vërejtje mbi të folmen e Dumresë*, Bulet. U.Sh.T. nr. 3, 1963. Mund të citohen edhe disa shkrime të profesor Gjinarit si: *E folmja e qytetit të Beratit*, Bulet. U.Sh.T. nr. 1, 1957; *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, Bulet. U.Sh.T. nr. 1, 1957; *E folmja e Skraparit*, Bulet. U.Sh.T. nr. 1, 1958; *Të folmet e Myzeqesë*, Bulet. U.Sh.T. nr.4, 1958; *Mbi të folmen e Devollit*, Bulet. U.Sh.T. nr. 4, 1960; *Vërejtje mbi të folmen e krahinës së Mallakastrës*, Bulet. U.Sh.T. nr. 3, 1963.

<sup>3</sup> *Gjuha letrare, drejtshkrimi dhe dialektet e shqipes*, SF, nr. 3,1973; *Guha letrare shqipe në një fazë të re*, SF, nr. 2, 1974; *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare me dialektet*, SF, nr. 1, 1985; *Marrëdhëniet e sotme të gjuhës letrare shqipe me dialektet*, në “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, Konf. Shk. Durrës, 15-17 dhjetor, 2010, QSA, IGJL, Botimet albanologjike, Tiranë, 2011.

<sup>4</sup> J. Gjinar, *Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, në “Konf. Stud. Alb.”, 1962, f. 1.

<sup>5</sup> Po aty, f. 1.

1. Në fonetikë, ekzistencën e zanoreve të gjatësisë së shkurtër dhe të mesme dhe mungesë e zanoreve të gjata; zanorja **ë** e theksuar ka një timbër të ndryshëm nga **ë** e labërishtes, duke u afruar me zanoren **e** të hapët. Zanorja **y** është karakteristike për këtë trevë, ndryshe nga nëndialektet e tjera, me përjashtim të disa të folmeve të labërishtes ku, në vend të saj, kemi **i** ose **u**. Një tipar tjetër është diftongu **ua**, i cili dallon nga togu zanor **ua** i labërishtes dhe çamërishtes. Bashkëtingëllorja qiellzore hundore **nj**, me përjashtim të disa të folmeve të Pogradecit, të Gorës, të Fushë së Korçës dhe të Tepelenës toske nuk ka evoluar, ndërsa në labërishte dhe në çamërishte kjo bashkëtingëllore ka evoluar në **j** (lyenj/liej). Gjithashtu, kemi edhe dukurinë e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës ose para bashkëtingëlloreve të shurdhëta, p.sh. *zok, bakti*.

2. Në morfologji, ndryshe nga të folmet jugore, këtu ruhet trajta e rasës vendore në raste si: *nëpër lumt, mbi gurt* etj. Gjithashtu, në të pakryer, tek foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*, ndryshe nga labërishtja dhe çamërishtja (*keshë, jeshë*), këtu ruhet e njëjta trajtë si në standard, kurse tek foljet e tjera e pakryera shfaqet në zona të caktuara në trajta të tilla si: *lanja / lanjam, qepnja / qepjam*.

Brenda këtij nëndialekti autori bën dy gupime të rëndësishme: a) grupi i të folmeve të anës perëndimore, ku përfshin: Myzeqenë, Beratin Mallakastrën, Skraparin, dhe Vlorën me rrethinat; b) grupi i të folmeve të anës lindore, ku përfshin thuajse gjithë zonën e Korçës: Fushën e Korçës, Oparin, Gorën, Pogradecin. Përveç tyre, autori dallon edhe dy nëngrupe: njëri juglindor, Danglli, Shqeri dhe, nëngrupi jugor, ku përfshihen fshatrat e Tepelenës toske, Këlcyra, Dëshnica dhe fshatërat e Skraparit në të majtë të Osumit.

Si tipare fonetike të përbashkëta për grupin perëndimor autori dallon: zanorja e theksuar në disa kontekste bashkëtingëllore nuk ka përfunduar në të gjitha rastet në **ë**, si në labërishte dhe çamërishte, p.sh. *peri, freri, emër, femër*. Gjithashtu, ë-ja fundore është gati e pandjeshme në fjalë si: *buk, moll, shikojm, ka dhën*, sikundër edhe në rrokje të hapët: *kput, ktu, vlla*, etj. Një dukuri tjetër, që vëren autori është ruajtja e diftongut **ua**, në rrokjet e mbyllura dhe në rrokjet e hapta brenda fjalës: *duam, shualli*, etj.

Nga ana tjetër, është asimiluar grupi **mb** në fund të fjalës: *krim (b), shkëm (b), trëm (b)*, etj.

Në morfologji vërehen dukuri të tilla si: formimi i kallëzores për emrat mashkullorë, që mbarojnë me bashkëtingëllore, trajta e shquar, duke futur një nyjë ndërmjet temës dhe mbaresës, p.sh. *fikun, malin*. Kemi përdorimin e përemrave dëftorë *qy, qo* në vend të *ky, kjo*. Në të pakryer, te foljet me bashkëtingëllore kemi mbaresat **-jam, -je, -te/ -im, -it, -in** (*qepjam*

...), kurse te foljet me zanore kemi mbaresat **-njam, -nje, -nte/ -njim, -njit, -njin** (*lanjam ...*).

Autori vëren me të drejtë se disa të folme të këtij grupi (Berati, Myzeqeja, dhe disa zona të Mallakastrës) ruajnë mbaresën **-ti** në të kryerën e thjeshtë pësore si: *u lati, u piti* etj. Tek një grup foljesh ai vëren se e formojnë të tashmen e lidhore, veta e dytë, me mbaresën **-nç** (*të punonç*), kurse një grup tjetër (përrjashto Skraparin) e formojnë vetën e tretë njëjës me të njëjtën mbaresë si dhe për shumësin si: (*ai*) *të ngasin, (ai) të mbytin* etj. Si prapashtesë zvogëluese dhe e përkëdhelisë përdoret **-z(ë)** si: *hënëz, mollëz, cazë*, etj.

Për grupin lindor ai vëren si dukuri fonetike ruajtjen e zanores **e** të theksuar si: *brenda, zemra, ze, le*, kurse lidhur me diftongun **ua**, ashtu si dhe në grupin perëndimor, ky diftong ruhet në rrokjet e mbyllura dhe në ato të hapëta brënda fjalës, p.sh. *buall, punuaka*.

Si dukuri morfologjike ai trajton çështje e përemrave pronorë, kur prona e pronari janë njëjës, veta e parë, si: *djalit tem, çupës teme*, kurse kur prona është shumës dhe pronari është njëjës, veta e parë dhe e dytë përdoret trajta *djemtë tim, çupat time/ djemtë tënd, çupat tënde*. Në vetën e tretë njëjës përdoret trajta *ay*.

Një dukuri tjetër morfologjike është edhe përdorimi i **v** si bashkëtingëllore antihiatizuese në raste si: *blevi, pivi, këndovi, lavi*, etj. Ai vëren gjithashtu se tri vetat e shumësit në të kryerën e thjeshtë dalin me mbaresat **-më, -të, -në**: *qepmë qeptë, qepnë*. Si për foljet që dalin me zanore, ashtu edhe për ato që dalin me bashkëtingëllore, e pakryera njëjës ndërtohet me mbaresat **-nja, -nje, -nte**, kurse shumësi është si i standardit, p.sh. *lanja, qepnja/ lanim, qepnim*.

Si prapashtesa, që u japin foljeve kuptim të kundërt, ai dallon **ç** dhe **x**, p.sh. *çkarkoj, xbath, çkul* etj. Gjithashtu, në këtë zonë vërehen edhe prapashtesa slave si: **-kë, -çkë, -ckë**, p.sh. *djaklkë, çupkë, nuskë* etj.

Për sa u përket dy nëngrupeve të vogla, atij juglindor dhe jugor, autori vë në dukje tiparet e përbashkëta të këtyre të folmeve në rrafshet e fonetikës dhe të morfologjisë. Për grupin juglindor ai thekson se, sikundër edhe në grupin perëndimor, **e** e theksuar, e ndjekur nga një nazale, ka dhënë përgjithsisht **ë**, por është ruajtur në rastet si: *freri, peri, emër, themër* etj. Gjithashtu, si dhe në të folmet jugore të këtij nëndialekti, kemi ruajtjen e diftongut **ua**, p.sh. *duam, ftua, shuall* etj. Për sa i përket rrafshit morfologjik, autori vëren se në të pakryer foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* i bëjnë tri vetat e njëjësit si: *kesha, keshe, kishte* ose *kish*. Po ashtu, në të pakryer, vihet re shtrirja e vetës së dytë edhe veta e parë, p.sh. (unë) *qepnje, lanje*. Kjo gjë vërehet edhe te forma pësore e së pakryerës, p.sh. *unë lodhëshe, ti lodhëshe*, kurse veta e tretë ruan mbaresën **-ej**, p.sh. *ay lodhej*.

Në grupin jugor ai vë re një ndikim të disa tipareve të labërishtes, gjë që shpjegohet me afërinë territoriale dhe frekuencën e kontakteve, shoqërore, kulturore, ekonomike dhe historike. Në fonetikë, ai vëren se në të njëjtat kontekste zanorja **e** e theksuar ka dhënë **ë**, p.sh. *vënd, zëmbër*, por edhe *përi, ëmbri, thëmbra, fëmra* etj. Është ruajtur gjithashtu diftongua **ua** (*ftua*), por shfaqen edhe diftongjet **ye** dhe **ie** (*dye, liej*). Për zonën e Tepelenës ai vëren se bashkëtingëllorja **nj** ka kaluar në **j**, p.sh. *laj, lëroj, lyej* etj.

Për sa i përket rrafshit morfologjik, autori veçon këto dukuri: Shumësi i emrave që mbarojnë me bashkëtingëllore e humbet **v**-në epentetike antihiatizuese në gjinore e dhanore, p.sh. *dhënet, barinjët, miqet* etj. Në fshatrat e Tepelenës, e pakryera njëjës në foljet e të gjitha kategorive bën sipas tipit: *laja/qepja, laje/qepje, lante/qepte*, kurse në shumës dallojnë foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore nga ato që mbarojnë me zanore: *qepim/lanim, qepit/lanit, qepin/lanin*. Nga ana tjetër, ashtu si dhe në të nëndialektet jugore, kemi mbaresën **ç** të përgjithësuar në lidhore, veta e dytë njëjës, p.sh. *të haç, të qepç, të vadiç, të zëç* etj.

Autori është i mendimit se “studimi i të folmeve të toskërishtes veriore ka një rëndësi të madhe edhe se ato janë pasqyruar në toskërishten e shkruar më shumë se të folmet e tjera jugore”.<sup>6</sup> Megjithë larminë e tyre, këto të folme, të përfshira në nëndialektin toskë (toskërishtja veriore), duket se krijojnë një shtrat gjuhësor më përfaqësues e gjithëpërfshirës për të hedhur themelet e gjuhës standarde në Kongresin e Drejtshkrimit (1972). Për ta zhvilluar më tej këtë tezë na vjen në ndihmë një artikull tjetër në “Studime filologjike”, ku profesor Gjinari mëton të përqsë toskërishten veriore me gegërishten jugore.<sup>7</sup> Studimet në historinë e gjuhës shqipe na bëjnë me dije se dy dialektet bazë të shqipes, ai toskë dhe ai gegë, kanë qenë më pranë njëri-tjetrit krahasimisht me gjendjen që shfaqin sot në tërë shtrirjen e të folmeve të tyre. Lidhur me këtë çështje E. Çabej pohon: “Nga kjo paraqitje nevojishtë përmbledhëse, e dukurive, shihet qartë se zbërthimi dialektor i sotëm i shqipes është përfundim i një diferencimi të kryer shkallë-shkallë në rrymë të kohëve. Edhe pak shekuj më parë, dy dialektet, megjithëse ishin të formuara me tiparet e tyre themelore, në shumë pika qëndronin më afër njëri-tjetrit sesa sot, në mënyrë që gjuha e një autori të Veriut si Gjon Buzuku (1555) dhe si Lekë Matrënga prej Siqilie (1592), paraqesin më shumë tipare të përbashkëta ndërmjet tyre nga ç’paraqesin dy dialektet kryesore në gjendjen e tyre të

<sup>6</sup> J. Gjinari, *Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmevet të saj*, në “Konferenca e parë e studimeve albanologjike”, 1962, f. 254.

<sup>7</sup> J. Gjinari, *Tipare të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me të gegërishtes jugore*, SF, nr. 2, 1965.

sotmen”<sup>8</sup>. Nga ana tjetër, pohimi në Kongresin e Drejtshkrimit se gjuha letrare e njësuar ishte mbidialektore ishte më shumë një pohim ideologjik kombëtar sesa një e vërtetë shkencore, e cila sot duket se ka rënë. Një tezë tjetër për shtratin e gjuhës standarde të njësuar ishte ajo e hedhur qysh më parë dhe u përforcua nga Xhuvani, ku baza gjuhësore të ishte elbisanishtja.<sup>9</sup>

Studimi përqasës i këtyre dy nëndialekteve (toskërishtja veriore dhe gegërishtja jugore) vinte në një kohë pararendëse të afërt të Kongresit të Drejtshkrimit dhe siç u përmend më lart, pas studimesh e anketash dialektologjike, që ishin ndërmarrë në shumë treva shipfolëse nga studiuesit tanë. Në literaturën studimore të vëzhguar tek ky autor nuk del në mënyrë eksplicite një tezë, e cila do të shtronte problemin e shtratit gjuhësor bazë mbi të cilin mund mbështetej kryesisht standardi i sotëm, por vetë hulumtimi dhe interesi studimor e afrojnë natyrshëm këtë studiues drejt një këndvështrimi të tillë. Duhet pohuar se studime dialektologjike përqasëse ndaj dy arealeve gjuhësore (gegë e toskë) në fazën pararendëse të Kongresit të Drejtshkrimit, me ndonjë përjashtim<sup>10</sup>, nuk kanë qenë fort në interesin e studiuesve; ndoshta për vetë natyrën e tyre ato mbylleshin në kufijtë gjuhësorë të territorit. Ndaj mendojmë se një studim përqasës si ky që përmendëm më lart na jep gjasa të besojmë se ky shtrat gjuhësor, i shtrirë gjeografikisht nga Vjosa deri në Mat, ishte dhe është natyrshëm më i njësuar se çdo qasje tjetër makro-territoriale. Autori pohon se “... shumë tipare të afërta ose të njëjta, që vërehen sot në toskërishten veriore e në gegërishten jugore, qofshin ato konservacione ose inovacione, janë më tepër rezultat i kontakteve të drejtpërdrejta që kanë pasur gjatë kohëve të ndryshme banorët e këtyre zonave.”<sup>11</sup>

<sup>8</sup> E. Çabej, *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, Studime gjuhësore IV, Prishtinë 1977, f. 192.

<sup>9</sup> Më herët, siç shprehet në përathënien e *Albaninesischen Grammatik* (1913), Weigand ndërmori ekspedita gjuhësore kryesisht në Durrës, Tiranë dhe Elbasan dhe, pas argumenteve të shprehura në të, shpjegon arsyet brëndagjuhësore e jashtëgjuhësore për ndërtimin e kësaj gramatike, duke marrë për bazë këto të folme. Një qëndrim tjetër në mbështetje të elbisanishtes është edhe ai i Komissë Letrare (1917), e cila shprehet në *Parime e rregulla mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkrueme të vendosuna prej Komissë Letrare*, § 1, se “orthografija e gjuhës do të jetë, për sa të mundet, fonetike; d.m.th. gjuha do të shkruhet ashtu si flitet prej popullit. Si themel i orthografisë do të mirret djalekti i Elbasanit me disa përmirsime”, cit. sipas Rexhep Ismajli në *Drejtshtkrimet e shqipes*, A.Sh.A.K., Prishtinë, 2005.

<sup>10</sup> Vlen të përmendet një studim i O. Myderizit, ‘Fjalori shqip-turqisht i H. Ali Ulqinakut’ (1961), ku autori shprehet se në leksik e folmja e Beratit ka ngjashmëri me të folmet e Shqipërisë së mesme, duke e ilustruar këtë pohim me shembuj të shumtë.

<sup>11</sup> J. Gjinari, *Tipare të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me të gegërishtes jugore*, SF, nr. 2, 1965, f. 129.

Në vijim të kësaj ideje autori sjell faktorë jashtëgjuhësorë, të cilët përlligjin dukuritë gjuhësore të përbashkëta, sikundër edhe dukuri breëndagjuhësore që shpërfaqin këtë njësim.

Ndër dukuritë gjuhësore ai përmend:

1. Territori, i cili shtrihet nga mbi Vjosa deri në Mat, me një dominim ultësire nga perëndimi dhe me një ngritje graduale malore drejt lindjes, me përjashtim të fushës së Korçës. Në këtë territor ka edhe lumenj të tjerë si: Osumi, Devolli, Shkumbini, Erzeni e Ishmi, të cilët përshkojnë këtë prerje territorial si kapilarë nga lindja në perëndim, duke mbledhur me dënduri të lartë përgjatë rrjedhjes së tyre pjesën më të rëndësishme të popullsisë së Shqipërisë politike. Në vijim të këtij argumenti studiuesi Gjinari thekson: “Të qenit e këtyre nëndialekteve kufi me njëri-tjetrin, relievi tokësor ku shtrihen ata, jo aq i vështirë për t’u kapërcyer, luginat e lumenjve dhe rrugët e komunikacionit (nga të cilat ka pasur bile edhe në kohët e lashta, si Via Egnatia me degët e saj që niseshin njëra nga Durrësi dhe tjetra nga Apollonia), kanë ndihmuar për të gjitha kontaktet e banorëve të këtyre trevave gjatë kohëve”<sup>12</sup>.

2. Faktori historik, i cili ka lidhje me territorin dhe që ka të bëjë me marrëdhëniet e hershme midis këtyre trevave si njësi administrative me shtrirje sa në toskërishte aq edhe në gegnishte, po të përmendim, bie fjala, shtrirjen e Arvanitasve deri në Çermenikë, Shpat e Mokërr<sup>13</sup>, përfshirjen e një pjese të madhe të qarkut të Korçës në sanxhakun e Ohrit dhe në territorin e valiut të Manastirit<sup>14</sup>, lidhjet e kahershme ekonomike të Korçës e Beratit me Durrësin, Elbasani si një qendër policentrike lidhesh me Beratin, Korçën, Lushnjën, Fierin e Vlorën. Një rol të rëndësishëm unifikues midis këtyre trevave toske e gege kanë luajtur banorët e trevave kalimtare, të cilët kanë pasur vazhdimisht marrëdhënie ekonomike, politike e fafefisnore me të dyja trevat.

3. Faktori etnokulturor, i cili ka shërbyer në këtë rol njësuës. Marrëdhëniet e territorit dhe ato ekonomiko-administrative doemos kanë impakt më të madh në marrëdhëniet fafefisnore, në traditën e zakonet, lidhjet martesore, këngët, vallet e meloditë. Melodia e këngëve të Beratit, deri diku edhe Fierit e Lushnjës është e afërt me Shqipërinë e Mesme (sidomos Elbasanit), gjë që vihet në dukje nga këngëtarë popullorë të këtyre trevave<sup>15</sup>.

Lidhur me bashkëpërkimet gjuhësore midis toskërishtes veriore dhe gegnishtes jugore studiuesi Gjinari thekson se (ato) ‘janë të ndryshme për nga

<sup>12</sup> J. Gjinari, *art. cit.*, SF, nr. 2, 1965, f. 130.

<sup>13</sup> *Historia e Shqipërisë*, V. I, f. 246.

<sup>14</sup> G. Hahn, *vep. cit.*, f. 39.

<sup>15</sup> R. Sokoli, *Disa veçanti të muzikës sonë popullore*, “Konf. Alb.”, Tiranë, 1962.

shtrirja territoriale, për nga sasia e rasteve ku çfaqen dhe nga sfera e gjuhës ku vërehen<sup>16</sup>.

Ndër bashkëpërkimet me shtrirje më të gjerë në të dyja të folmet autori argumenton çështje të zanoreve **a** dhe **e** në kontekste bashkëtingëlloresh hundore, si:

Së pari, në gegnishte jugore, **a** + bashkëtingëllore hundore del **a** hundore, kurse në toskërishte veriore del **ë**, ndërsa **e** + bashkëtingëllore hundore, që në gegënishte del si **e** hundore, nuk del si **ë** në të gjitha të folmet e toskërishtes jugore. Me përjashtim të Tepelenës, Mallakastrës, ku procesi është i ngjashëm me të folmet e Labërisë dhe Çamërisë, në të folmet e tjera procesi duket i ndërprerë. Për shembull, në qarkun e Korçës kemi *mënt, vënt*, por nga ana tjetër kemi një **e** johundore në raste si: *dhen, qen, zemër, gjendje, ve, le, ze* etj. Edhe në zonën e Përmetit kjo dukuri është konservuar në raste si: *pe, fre, qen, femër, emër, gjenj* etj. Në Berat gjithashtu, krahas *qënq, qën*, vësht, kemi *e enjte, e premtë, shtrenjt* etj., në Myzeqe kemi edhe foljet *ze, le, ve* etj.

Së dyti, dukuria e dytë që vëren autori ka të bëjë me reduktimin e **ë**-së atone. Jo të gjitha të folmet e toskërishtes veriore ngjajnë me të folmet gegnishtes jugore, madje disa syresh nuk puqen fare<sup>17</sup>. Të folmet e Beratit, Mallakastrës dhe Myzeqesë e kanë reduktimin e **ë**-së në pozicione të shumta të ngjashme me ato të Shqipërisë së Mesme, në shembuj si: *moll, les, buk, rriponj*, ose në raste proklitike, si: *n shkoll, nj çkë, m dysh, t ket, t tër*, kurse të folmet e qarkut të Korçës dhe të Skraparit kanë shfaqje të pjesshme të kësaj dukurie. Edhe në rrokje nistore si: *vlla, ktu, ktej, tshër, knaq, dgjon* etj., në pozicione protonikosematone si: *dimri, pjeprin, akri*, apo pozicione postonikosematone si: *bakti, shqiptar, plotson, praopsoj* etj., kemi bjerrje të zanores **ë**.

Së treti, një ngjashmëri me gegnishten vërehet edhe për sa i përket kallëzores anaptikse tek emrat me **i** dhe **u** (malin, gjakun), e cila në Berat dhe Myzeqe shfaqet si formë e vetme, por ka shtrirje edhe në të folme të tjera të toskërishtes veriore.

Së katërti, ngjashmëri shfaqen edhe për sa i përket rasës vendore të tipit: *në gurt, në gropt, nëpër lumt* etj.; te përemrat pronorë të tipit: *djali/gocata/tate, djali/çupa tënt, tënde*. Ka ngjashmëri me gegnishten edhe për sa i përket vetës së parë dhe të dytë të foljeve që mbarojnë në bashkëtingëllore, sidomos Berati, Myzeqeja, Korça dhe fusha e saj, Derdiku dhe Skrapari.

<sup>16</sup> J. Gjinari, *Tipare të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me të gegërishtes jugore*, SF, nr. 2, 1965, f. 131.

<sup>17</sup> S. Floqi, *Skicë e së folmes së Dangllisë*, Bulet, U.S.H.T. Seria shk. shoq. nr. 3. 1958.

Së pesti, ka ngjashmëri edhe në fjalëformimin e emrave abstraktë prej mbiemrave prejpjesorë, si: *e mbjella, e lamja, e folura, e zëna, e vrara, e vjela* etj.

Për sa u përket bashkëpërkimeve të pjesshme dialektologu Gjinari vëren se, përsa i përket oksitonisë, Jugu dallohet nga Veriu lidhur me theksin fundor a parafundor për fjalët turke si *kafé/káfe, xhezvé/xhézve, qofté/qófte, dairé/dáire* etj., mirëpo kemi disa të folme të qarkut të Korçës që ngjajnë me gegnishten lidhur me pozicionin e theksit si: *báxha, qése, shíshe, dáire* etj. Gjithashtu, megjithëse në mënyrë sporadike, në disa të folme të Myzeqesë, shfaqet dukuria e labializimit të **i**-së në **y**, tipar ky i ngjashëm me gegnishten jugore (Tiranë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë) në raste si: *shpyrt (shpirt), vrymë (vrimë), qylym (qilim)* etj.

Një tjetër ngjashmëri me Shqipërinë e Mesme është edhe reduktimi i **u**-së atone në disa pozicione, kryesisht para **-ll**. Kjo ngjashmëri shtrihet në zona si Myzeqe, Berat e Mallakastër dhe shfaqet në raste, ku **u**-ja reduktohet në **ë**, p.sh. *kumbëll, kukëll*, etj., të cilat në të shquar e humbasin plotësisht edhe **ë**-në, duke dhënë *kuklla, kumblla* etj. Gjithashtu, kemi edhe dukurinë e shndërrimit të **ë**-së atone në **i**, në pozicion para rrokjes së theksuar. Kjo ngjashmëri me gegnishten jugore vihet re në Myzeqe, Berat dhe Mallakastër dhe në ndonjë rast edhe në zonën e Korçës, p.sh. *nji vlla, asnji dhi, gjikundi, gjikafshë, njizet*, etj. Një bashkëpërkim tjetër është edhe ai i reduktimit të grupit **mb** në **m**, në pozicione fundore të fjalës si: *dhëm, shkëm, këm, u trëm, u shëm* etj.

Ngjashmëri me Shqipërinë e Mesme kemi edhe ndërrimin e **h**-së me **f**, në zonën e Myzeqesë, në raste si: *i nxeftë, i ftoftë, llaftar (llahtar)* etj. Në zonën e Korçës kemi ngjashmëri në rasat gjinore dhanore e kallëzore te përemrat pronorë të vetës së parë dhe të dytë njëjës, kur prona e pronari janë njëjës, p.sh. (*i, e*) *djalit tem, djalin tem, (i, e) çupës teme, çupën teme*. Gjithashtu, ndërsa në toskërishten veriore, për sa i përket vetës së parë njëjës, koha e tashme, është ruajtur modeli **-n/nj**, në folje të tipit *lanj, lëronj, lyenj*, në zonën e Pogradecit, Gorës dhe Fushës së Korçës, ashtu si dhe gegnishtja, është ruajtur mbaresa **-j**, p.sh. *bluaj, ruaj, lyej* etj.

Një lidhje e pjesshme me disa të folme geqe është edhe përdorimi i të pakryerës, veta e parë njëjës me **-am** dhe **-em**, në raste të tipit: *lanjam, flisnjam, lidhjam, hajshem, krifshem*. Ndikime të gegnishtes vihen re edhe te të folmet e Pogradecit e të Gorës në përdorime të tipit: *të lidhish, të qepish, të mbjelli, të fleri, të zeri*, etj.

Si përfundim mund të themi se ne sollëm vetëm një pjesë të dukurive gjuhësore që e bashkojnë këtë trevë, duke krijuar një tërësi gjeolinguistike, falë kompaktësisë dhe marrëdhënieve historike e etnokulturore që kanë pasur banorët e këtyre trevave. Faktorët që përmendëm më lart janë padyshim

përcaktues për gjendjen gjuhësore të këtij areali. Nga ana tjetër kjo përjasje shërben për të treguar se ndarja me thikë e dy dialekteve jo vetëm nuk ka qenë dhe nuk është një realitet, aq më pak dobiprurës për standardin, por ky realitet i djeshëm dhe i sotëm, nën procesin e urbanizimit e përqëndrimit demografik, po shërben si shtrat përbashkues i pjesëve më të skajshme. Por ky pohim ka nevojë të verifikohet me gjendjen e sotme të gjuhës në përdorim. Studimet mund të sqarojnë më tej se si kanë evoluar konstatimet e katër, pesë dekadave më parë, të bëra nga prof. Gjinari dhe dialektologë të tjerë dhe se si zhvendosjet e popullsisë drejt qendrave urbane e metropolit si dhe drejt bregdetit shfaqin një pamje të re të gjendjes dialektore dhe një ndërthurje të re të këtij “miksimit gjuhësor” me standardin drejt gjuhës në përdorim. Prej këndeje merr vlerë vepra studimore dialektologjike e prof. Gjinarit, sepse ajo mbetet një pikë reference shkencore e sigurt për të ndërmarrë studime të ardhme, të cilat do të ndriçojnë rrugëtimin gjuhësor të këtyre trevave bashkërisht me gjithë gjuhën shqipe.

## BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1984), *Historia e Shqipërisë*, Vëllimi I. Çabej, E. (1977), *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, “Studime gjuhësore”, IV, Prishtinë.
- Dozon, A. (1879), *Manuel de la langue Chkipe ou Albanaise*, Paris: Leroux.
- Floqi, S. (1958), *Skicë e së folmes së Dangllisë*, Buletin i U.SH.T. Seria shk. shoq. nr. 3. 1958.
- Gjinari, J. (1957), *E folmja e qytetit të Beratit*, Buletin Shkencor, Shkodër, 1957/1. f. 109-141.
- Gjinari, J. (1957), *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, BUSHT SSSH, 1957/1, f. 134-166.
- Gjinari, J. (1958), *E folmja e Skraparit*, BUSHT SSSH, 1958/1, f. 86-107.
- Gjinari, J. (1960), *Mbi të folmen e Devollit*, BUSHT SSSH, 1960/4, f. 103-137.
- Gjinari, J. (1962), *Vërejtje mbi të folmen e krahinës së Mallakastrës*, BUSHT SSSH, 1962/3, f. 148-150.
- Gjinari, J. (1965), *Tipare të të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me të gegërishtes jugore*, SF, 1965/2, f. 129-138.
- Gjinari, J. (1965), *Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, në “Konferenca I e Studimeve albanologjike” (nëntor 1962), Tiranë.
- Hahn, G., J. (1854), *Albanesische Studien*, Jena: Friedrich Mauke.
- Haxhihasani, Q. (1955), *Një vështrim mbi të folmen e krahinës së Sulovës*, Bulet. Shk. Shoq. nr. 3.

- Komisija Letrare Shkodër (1917), *Parime e rregulla mbi ortografin e gjuhës shqipe të shkrueme të vendosuna prej komisis letrare*, cit. sipas Rexhep Ismajli në “Drejtskrimet e shqipes”, A.Sh.A.K., Prishtinë, 2005.
- Çeliku, M. (1963), *Vërejtje mbi të folmen e Dumresë* Bulet. U.Sh.T. nr. 3.
- Myderizi, O. (1961), ‘*Fjalori shqip-turqisht i H. Ali Ulqinakut*’ Bulet. i Shke.Shoq. U.Sh.T., nr. 3, 1961.
- QSA, IGJL (2011), *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*”, Konf. Shk. Durrës, 15-17 dhjetor, 2010 Tiranë: Botimet albanologjike.
- Sokoli, R. (1962), *Disa veçanti të muzikës sonë popullore*, “Konf. Alb.”, Tiranë.
- Thomaj, J. (1961), *E folmja e katundit Seman*, Bulet. U.Sh.T., nr. 3.
- Weigand, G. (1913), *Albaninesischen Grammatik*, Leipzig: Johann Ambrosius Barth.
- Xhaçka, V. (1958), *Një vështrim mbi të folmen e Devollit*, Bulet. U.Sh.T. nr. 3.

## SUMMARY

### NORTH DIALECT (TOSK) AND SOUTH DIALECT (GHEG) IN JORGJI GJINARI'S PERSPECTIVE

Jorgji Gjinari is one of the most distinguished Albanian dialectologists. He set the example that the facts of Albanian language might be studied better synchronically, when they are touched upon *ex cathedra*, right where they exist. This is also the reason why his researches are coherent and of a great importance. Amidst his manifold scientific contribution, the scholar Gjinari paid close attention to the varieties of the Northern Tosk, by contrasting it to the Southern Tosk variety. He emphasizes that: “The study of the varieties of the Northern Tosk is of a crucial importance” and that “they are reflected in the written Tosk, more than the other Southern varieties” (Gjinari 1962). This comparison is useful to demonstrate that the sharp division among the two dialects has not been and it is not a reality, especially not a convenient one to the standard of Albanian. But, that reality of yesterday and of today, due to the process of urbanization and demographic concentration, are serving as a unifying ground of the extreme components. Nevertheless, this claim has to be verified in the actual situation of the language in use. Further research might shed light to how the assertions of four or five previous decades, made by professor Gjinari and other dialectologists, and how the relocation of the

population toward urban centers, the metropolis and the seacoasts present a new perspective of the dialects situation and a new combination of this “language mixture” with the standard toward the language in use.